



Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë / Uprava za Poljoprivredu i šumarstvo / Department of Agriculture and Forestry

Në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale" nr.03/L-040, neni 62, pika 3, si dhe neni 19 dhe 20 rregullores komunale për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes të subvencioneve e ndryshuar dhe plotësuar me rregulloren nr. 2/2018, 01 nr. 16-28468 dt. 22.03.2018, si dhe duke u bazuar në planin e punës për vitin 2023 Drejtoria për Bujqësi dhe pylltari shpall:

FTESE PUBLIKE

Për aplikim për "Hapjen e Puseve për ujitjen e tokave bujqësore"

Të drejtë aplikimi kanë: Të gjithë fermerët e komunës së Gjilanit të cilët janë kultivues të pemëve, perimeve kulturave lavërtare si dhe mbarështimin e fermave blegtorale që kanë mungesë të ujit apo kanë sasi të kufizuara.

Kriteret e përzgjedhjes

1. Të posedoj pëmishte dru frutore mbi 50 ari të punuar në një vend ose pemë të imta mbi 30 ari
2. Të posedoj së paku 30 ari të mbjella me perime në fushe të hapur ose mbi 5 ari serra
3. Të posedoj të mbjellë së paku 50 ari patate, fasule kultura Lavërtari
Të posedoj fermë të Gjedit mbi 5 krerë, dele, dhi mbi 30 krerë, pula mbi 2000 copa
4. Çdo parcelë duhet të ketë qasje në rrugë
5. Në mungesë të aplikacioneve që plotësojnë këto kriteret mundë të vin në konsiderim fermerët me kushte të përafërta
6. Tek pusët me shpurje të ngushtë Ø 140 mm komuna bën shpuarjen deri në 40 metra ndërsa pjesën tjetër e vazhdon vet Fermeri me mjete vetanake
7. Shpuerja me gypa Ø 1000 mm bëhet deri në 40 m. (max)

Dokumentet e nevojshme:

- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
- Fleta poseduese mbi tokën (original), aty ku prona nuk është e rregulluar plotësohet deklarata e noterizuar
- Skica e parcelës ku planifikohet hapja e pusit
- Rexhistri i kafshëve nga ambulantja veterinare lopë, dele, dhi, pula etj

Afati për aplikim është i hapur 10 (dhjetë) ditë pune nga data **19.10.2023** deri me **31.10.2023**
Aplikimet dorzohen në Qendrën për Shërbim me Qytetarët

Me 19.10.2023

Gjilan

Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarisë ing. B. Isufi